




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr 28/2008, nenit 51 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr. 01-013/ 491 të datës 21.04.2011, në bazë të Memorandumit të bashkëpunimit me nr. protokoli 02-016/167 i datës 20.02.2017, Kryetari i Komunës së Vitisë, bien këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ 3,710.00€ KLUBIT TË FUTBOLLIT “VLLAZNIA”

I

Me këtë Vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë **NDAN** mjete financiare në shumë prej **3,710.00€** me shkronja (tre mije e shtatqind e dhjetë euro) klubit të futbollit “Vllaznia”, në emër të përmbushjes së obligimeve të cilat dalin nga Memorandumi i nënshkruar mes Komunës së Vitisë dhe k.f “Vllaznia”

II

Mjetet nga neni 1 i këtij Vendimi, sigurohen nga Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2017 nga kodi buxhetor për subvencione i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Shuma e mjeteve prej **3,710.00€** derdhet në llogari të k.f “Vllaznia”. Obligohet Drejtori financiar i k.f “Vllaznia” të paraqet raport me shkrim për mjetet e shpenzuara nga neni 1 i këtij vendimi të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Vitisë

III

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe Zyra e Thesarit të Komunës së Vitisë

IV

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kryetarit të Komunës së Vitisë.

DREJTORESHA E DKRS-së
Kaltrina G. SYLEJMANI

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË
Sokol HALITI



Vendimi u dorëzohet:

1. K.f “Vllaznia”
2. Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
3. Zyrës së thesarit dhe
4. Arkivi